



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.03.2021

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.03.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës", me Nr. të Prok: 632-20-7505-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-20-119-211. nxjerr:

### V E N D I M

- II. 1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Rojet e nderit" SH.P.K., e dt. 09.03.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës", me Nr. të Prok: 632-20-7505-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-20-119-211., kundër **Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit**, te AK –së, të datës 05.03.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. **Vërtetohet NJOFTIMI PËR ANULIM TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë: 05.03.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## Arsyetim

- I. Operatori Ekonomik "Rojet e nderit" SH.P.K.me datë 05.03.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës", me Nr. të Prok: 632-20-7505-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-20-119-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.03.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Kërkesa e juaj për rishqyrtim është e pa bazë sepse Autoriteti kontraktues konsideron se oferta juaj është mbi vlerën e parashikuar.

Sa i përket kalkulimeve tuaja të prezantuara në kërkesën për rishqyrtim ku keni konsideruar se edhe pse oferta juaj tejkalon vlerën e parashikuar me devijimin e lejuar nga sasia totale indikative 30% +/- mbulohet ajo pjesë, Autoriteti Kontraktues sqaron se devijimi i lejuar 30% +/- është mundësi që ipet në kontratat kornizë por jo detyrueshme.

*Andaj ky fakt mjafton që kërkesa e juaj të konsiderohet e pa bazë.*

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Faton Gutaj  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës